



KOMUNA E PRISHTINËS
RAPORT MUJOR

Drejtoria	DUNMM
Periudha raportuese	Janar 2016
Emri dhe mbiemri i raportuesit	<i>Heroina Maloku</i>

1. PËRMBLEDHJE

Përmbledhje e përgjithshme rreth mbarëvajtjes/ecurisë së punës për muajin raportues, janar 2016.

Meqë muaji janar është muaji i parë e vitit, nënkupton që është dhe muaji i planifikimit të aktiviteteve për vitin vijues, si dhe parapërgatitja e fillimvitit të ri për një performancë sa më cilësore në mbylljen e vitit. Edhe pse gjatë muajit janar bëhet planifikimi i aktiviteteve, në anën tjetër bëhet dhe përmbyllja e aktiviteteve të vitit të kaluar. Në Drejtorinë e Urbanizmit, Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, pothuajse në të gjithë sektorët është i njëjti fenomen i aktiviteteve: përmbyllje-planifikim.

Në Sektorin e planifikimit vazhdon puna me informata nga plani. Kemi filluar me hulumtime dhe mbledhje të materialit për konkursin e zonës " Qendra ", si dhe, çka është më e rëndësishmja, është duke u bërë përgatitja e sektorit për formimin e data-bazës në sistemin "Gis", e cila ndihmon në hartimin e dokumentit të Hartës zonale të Komunës.

Në Sektorin e urbanizmit kemi filluar me takime të shpeshtuara të Grupit profesional-Kolegjumit, me qëllim të përfundimit të lëndëve nga viti i kaluar dhe fillimi i punës sipas strukturës së re në sektor- zyrtarët shqyrtues që do të merren me shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore për objektet e kategorisë së parë, dhe kërkesat për leje ndërtimore për dy kategoritë. Grupi profesional do të merret me shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore për objektet e kategorisë II, si dhe kërkesat tjera sa i përket definimit të pronës. Ky grup do të bëjë kontrollin e lëndëve pas shqyrtimit të parë nga zyrtarët bartës të lëndëve.

Ka filluar puna me unifikimin e formave për kushte ndërtimore, letrave- informatave, pëlqimeve të ndryshme, lejeve ndërtimore, formës së refuzimit dhe dokumenteve të tjera që lëshohen nga kjo drejtori.

Gjatë këtij muaji në Sektorin e urbanizmit janë trajtuar 118 kërkesa të ndryshme. Janë caktuar kushte për 3 (tri) kërkesa, janë lëshuar 5 (pesë) leje ndërtimi, një ndërtesë shumëkatëshe, ndërsa të tjerat shtëpi individuale, janë lëshuar 3 vendime - pëlqime të ndryshme, janë refuzuar 25 (njëzet e pesë) kërkesa, si dhe shumë informime për plotësim dokumentacioni, aktvendime kompensimi e të ngjashme.

Të dhëna statistikore për Sektorin e Urbanizmit:

<i>Lëndë të pranuar - Janar</i>	<i>Kushte ndërtimore</i>	<i>Leje ndërtimore</i>	<i>Konstatime për refuzim</i>	<i>Vendime - pëlqime</i>	<i>Lëndë në procedurë</i>
118	3	5	25	3	150

Zyra për marrëdhënie me publikun, gjatë muajit janar, u ka kushtuar vëmendje prononcimeve mediale, të cilat në të shumtën e rasteve kanë qenë për Sektorin e legalizimit. Duke pasur parasysh mbingarkesën dhe punët e shumta në drejtori, këtë vit kësaj zyre i është shtuar edhe përgjegjësia e pranimeve teknike, detyrë e së cilës është menaxhimi i Sektorit për pranime teknike, që do të thotë analizimi i situatës paraprake, si dhe përpilimi i rregulloreve të reja drejt përcaktimit të komisionit për pranim teknik. Synim i Drejtorisë është që brenda këtij viti, paralelisht me procesin e legalizimit, të pajisen me leje përdorimi të gjitha ndërtesat të cilat kanë leje ndërtimi.

2. *AKTIVITETET E PLANIFIKUARA*

Aktivitetet për muajin raportues, të parapara sipas planprogramin të Komunës:

- Zbatimi i bazës ligjore për planifikim e ndërtim, shqyrtimi i lëndëve, duke respektuar afatet ligjore;
- Unifikimi i dokumenteve që lëshohen nga Sektori i urbanizmit;
- Vlerësimi i lëndëve nga Kolegjiumi, si dhe marrja e vendimeve për lëndët ku ka dilema në zgjidhje në Sektorin e urbanizmit;
- Përpunimi i ueb-faqes së Komunës sa i përket Drejtorisë;
- Takimet me qytetarë të interesuar për zgjidhjet urbane deri në arritjen e zgjidhjes dhe përgatitjet para aplikimit për kushte ndërtimore;
- Procedurat e miratimit të rregullores për taksën e re ndërtimore;
- Kryerja e lëndëve në afat, në bazë të kërkesave të palëve;
- Përgatitja e detyrave projektuese;
- Mbikëqyrja e kontratave të të gjitha llojeve;

- Finalizimi i rregulloreve të filluara;
- Përgatitja e raportit mujor, tremujor, gjashtëmujor dhe atij vjetor;
- Këshillimi i drejtorit dhe sektorëve të tjera për çështjet e ndërtimit;
- Aktivitete të paplanifikuara, me kërkesë të organeve të Komunës;
- Përgatitja e lëndëve arkivore deri në vitin 2008, për dorëzim në Arkivin Komunal;
- Përgatitja e rregullores për taksa dhe tarifave për dhënien e lejes ndërtimore;
- Takimet me institucione të cilat caktohen paraprakisht në mënyrë të zgjerimit të rrjetit komunikues drejt krijimit të marrëdhënieve ndërvepruese;
- Përpilimi i listës së aplikimeve për pranime teknike nga viti 2000 deri në vitin 2015 dhe klasifikimi i aplikimeve deri në cilën fazë janë përfunduar;
- Përpilimi i raportit për vitin 2015 për DUNMM-në;
- Përfundimi i projektit zbatues për parkun “Bllok pas blloku”;
- Fillimi i punës për ndërtimin e data-bazës në sistemin “Gis”;
- Analiza e PZHK- së dhe PZHU-së;
- Detyra projektuese për konkursin e zonës " Qendra 1 dhe 2 ".

3. *AKTIVITETET E IMPLEMENTUARA*

Aktivitetet e implementuara dhe aktivitetet që janë në implementim e sipër, gjatë periudhës raportuese:

- Trajnimi i stafit për plotësimin e “Permit Tracking System” me lëndët e muajve në vijim;
- Përfundimi i lëndëve me dokumente konkrete;
- Publikimi i lejeve ndërtimore në ueb-faqen e Komunës;
- Mbikëqyrja e projekteve që realizohen nga investimet kapitale të Komunës;
- Takimet e rregullta të zyrtarëve shqyrtues me grupin profesional - kolegjiun për lëndë konkrete;
- Takime të shumta me qytetarë për arritjen e zgjidhjeve urbane para kushteve ndërtimore;
- Përgjigje në kërkesa të ndryshme sa i përket punës së sektorit;
- Përgatitje për plotësim-ndryshimin e ueb-faqes së Komunës sa i përket DUNMM-së;
- Pjesëmarrje aktive në hartimin e Planit të veprimit për energji të qëndrueshme (PVEQ-SEAP) dhe mbikëqyrjen e zbatimit;
- Caktimi i komisionit për 8 kompani ndërtuese, të cilat kanë aplikuar për pranim teknik;
- Intervistimi i mbi 100 aplikuesve për praktikë në DUNMM;
- Përzgjedhja e tyre në kuadër të profesionit dhe punëve të caktuara që duhet bërë në DUNMM;
- Ndarja e lokacionit për memorialin e KFOR-it sllovak në Parkun e qytetit;

4. *AKTIVITETET NË IMPLEMENTIM E SIPËR*

Aktivitetet që janë në implementim e sipër për muajin raportues:

- Vazhdohet me zbatimin e bazës ligjore, duke u përpjekur që të respektohen afatet ligjore;
 - Pjesëmarrje në Grupin punues, të thirrur nga MMPH për plotësim-ndryshimin e Rregullores për normat minimale teknike për ndërtesat e banimit, në bashkëpronësi dhe hapësirat në funksion të tyre;
 - Vazhdon puna në përmirësimin e sistemit të informimit për monitorimin e procedurës së marrjes së lejes së ndërtimit nga qytetarët, si masë e transparencës;
 - Vazhdon puna në unifikimin e dokumenteve që lëshohen nga Drejtoria, si masë e funksionalizimit të skemës së re të ristrukturuar të stafit;
 - Po punohet në rritjen e efikasitetit të punës së grupit profesional – Kolegjiumit, ashtu që të mos paraqiten vonesa në shqyrtim të lëndëve;
 - Fillohet me përdorimin e fletëshqyrtimeve gjatë shqyrtimit të lëndëve nga ana e zyrtarëve shqyrtues, me qëllim të lehtësimit të punës së tyre, si dhe ndarjes së përgjegjësisë;
 - Po punohet në zgjidhje urbane të ndryshme deri në miratimin e tyre;
 - Po vazhdon publikimi i të gjitha lejeve ndërtimore të lëshuara nga Sektori i urbanizmit duke punuar me kronologji nga lejet e fundit;
 - Janë duke u identifikuar pengesat në zbatim të planeve:
- Plani rregullues i hollësishëm "Mati 2", dërgimi në Kuvend për lenie në dispozicion për publikun;
- Plani rregullues i hollësishëm "Kodra e Trimave 1", dërgimi në Kuvend për lenie në dispozicion për publikun;
- Plani rregullues i hollësishëm "Sofalia", plotësimi dhe ndryshimi, dërgimi në Kuvend për miratim.

4.1.2. Buxheti i planifikuar dhe ai i shpenzuar për periudhën raportuese

4.1.3 Takimet me palë

Takimet me palë vazhdojnë të mbahen të martave dhe të enjteve, me përjashtime edhe ditëve të tjera, sipas nevojës.

4.1.4. Takimet me institucione të tjera

Edhe gjatë kësaj periudhe janë realizuar shumë takime me institucione qendrore - ministritë e linjës, si dhe organizata të huaja, me qëllim të realizimit të aktiviteteve të ndryshme dhe rritjes së bashkëpunimit ndërinstitucional.

- Takimi me përfaqësues të Universitetit të Prishtinës, diskutim rreth pronave të Universitetit;
- Takimi me përfaqësues të KOSTT-it, diskutim rreth problematikave të ndërtesave të KOSTT-it në kuadër të qytetit;
- Takimi me përfaqësues të Bashkësisë Islame të Kosovës.

5. DISKUTIMET PUBLIKE/Takimet me qytetarë

5.1.1. Kërkesat për qasje në dokumente zyrtare

5.1.2. Lëndët e pranuar, të kryera dhe në përfundim e sipër.

Në tabelë gjeni të dhënat për Sektorin e urbanizmit lidhur me kërkesat e pranuar, të përfunduara dhe në procedurë:

Lëndët e pranuar-janar 2016	Të kryera – janar 2016	Në procedurë – janar 2016
118	70	150

Në numrin e përgjithshëm prej 70 lëndëve të kryera, 20 janë refuzime, të cilat bëhen në bashkëpunim me zyrtarët ligjorë, derisa janë kryer edhe shumë aktivitete në proces të përcaktimit të kushteve ndërtimore, si dhe lëshimit të lejeve të ndërtimit, që nuk mund konsiderohen si kryerje e lëndës, por aktivitete që ndikojnë në kryerje të lëndëve.

Në Sektorin e legalizimit gjatë muajit raportues janë pranuar 53 aplikime, 273 trajtime dhe asnjë legalizim.

Është bërë klasifikimi i 136 aplikimeve për inspektim profesional, në bazë të profesioneve, ku rezulton në:

- 46 Arkitekturë;
- 29 Ndërtimtari - Drejtimi konstruktiv;
- 8 Ndërtimtari - Drejtimi hidroteknik;

- 24 Inxhinieri Elektroteknike;
- 19 Inxhinieri Mekanike;
- 6 Juridik;
- 5 Mbrojtje nga zjarri.

Në Sektorin e planifikimit:

- 53 lëndë të pranuar;
- 4 lëndë në procedurë.

6. TAKIME TË TJERA

Gjatë këtij muaji Sektori i Urbanizmit ka realizuar shumë takime edhe me drejtori të tjera, si Drejtorja e Pronës dhe Financave, Drejtorja e Kadastrit dhe Drejtorja e Infrastrukturës, duke mos i lënë anash edhe takimet e shpeshta me Inspektoratin, me qëllim të bashkërendimit të aktiviteteve.

7. SFIDAT - Nëse gjatë implementimit të planeve është hasur në vështirësi të ndryshme, p.sh. pengesa brenda Drejtorisë, Komunës, apo institucioneve të ndryshme, ju lutëm shpjegoni në këtë hapësirë.

Afatet ligjore po i afekton pajisja me dokumentacion nga Drejtorja e Pronës dhe Drejtorja e Kadastrit. Sfidë vazhdon të mbetet edhe parcelimi sipas Planit rregullues “Prishtina e Re”, i cili në të shumtën e rasteve pengon zhvillimin e parcelave, ngaqë parcelimi nuk ka respektuar gjendjen faktike të parcelave ekzistuese.

Sfidë paraqet mungesa e përshkrimit të përgjegjësive të zyrtarëve shqyrtues, si dhe zyrtarëve të tjerë që shqyrtojnë fazat e projektit. Sfidë për Sektor po paraqet edhe ngarkesa me lëndë nga legalizimi për objektet e papërfunduara të regjistruara në regjistrin e ndërtimeve pa leje.

8. REKOMANDIME

- Të mos përfshihen zyrtarët e Sektorit në komisione të ndryshme, sepse janë të ngarkuar me lëndë;
- Të realizohen punët e nevojshme për sigurimin e një zyre me tavolinë dhe karrige ekskluzivisht për takime – prezantime, duke siguruar pajisjet e nevojshme për të

mundësuar punën drejtpërdrejt në kompjuter, monitor dhe pajisjet përcjellëse për punë grupore;

- Të mundësohen trajnime ose vizita zyrtare të stafit sa i përket procedurës për pajisje me leje ndërtimore, si dhe për regjistrimin, skedimin dhe arkivimin e dokumenteve.

9. *AKTIVITETET E PLANIFIKUARA PËR MUAJIN PASUES :*

- Vazhdimi me shqyrtimin e lëndëve të bartura nga viti paraprak (miratim, refuzim);
- Procedimi i lëndëve sipas afatit kohor të paraparë me ligj;
- Plotësim-ndryshimi i ueb-faqes së Komunës – DUNMM-së;
- Organizimi i takimit të punës për përfundimin e formave standarde të dokumenteve që lëshohen nga DUNMM-ja;
- Organizimi i takimit të punës për procesin e legalizimit dhe trajtimit të kërkesave për leje ndërtimi për objektet e papërfunduara, të filluara pa leje;
- Konsultime me palë në lidhje me projektet - në formë të shtypur në formatin A3 (para fazës së aplikimit për leje);
- Vazhdimi i plotësimit me informata të programit “Permit tracking system” dhe organizimi i azhurnimit të të dhënave dhe publikimi i lejeve të lëshuara në ueb-faqe;
- Aktiviteti rreth avancimit të shërbimit të informimit të qytetarëve për procedurat e urbanizmit;
- Vazhdimi i publikimit të lejeve të ndërtimit në ueb-faqe të Komunës;
- Miratimi dhe publikimi i taksës së ndërtimit, si dhe tarifave përkatëse;
- Takimet me institucione të cilat kanë aktivitete të vazhdueshme;
- Përpilimi i rregullores për pranime teknike;
- Krijimi i një strategjie rreth mbarëvajtjes dhe rrjedhojës së punëve për pranime teknike;
- Diskutimi publik për rregulloren e taksave dhe tarifave për leje ndërtimore;
- Fillimi i punës për ndërtimin e data-bazës në sistemin “Gis”;
- Analiza e PZHK-së dhe PZHU-së;
- Detyra projektuese për konkursin e zonës " Qendra 1 dhe 2 ".

10. *TË TJERA - Shënimi çështjet tjera që mendoni se janë me rëndësi të raportohen e që nuk kanë qenë të përfshira në pikat e mësipërme*